



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P 60/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.02.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-37288-12-11-2017 me objekt: “Sherbimi i sigurise fizike te objekteve te Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd”, me fond limit 8 737 942 lekë pa tvsh, e parashikuar për t’u zhvilluar në datën 10.01.2018 autoriteti kontraktor, Sh.a Ujesjelles-Kanalizime Librazhd.

Ankimues:

“Eurogjici Security” shpk
Rruga “Adem Jashari”, Lgjia 8, H. 10, Ap.3, Tiranë

“Dea Security” sh.p.k
Rr “Ndre Mjeda”, Qendra Polifunksionale, Kati I,
Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Sh.a Ujesjellës-Kanalizime Librazhd
Sheshi Agjensisë Librazhd

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin

dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili i ka refuzuar ato, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.12.2017 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-37288-12-11-2017 me objekt: “*Sherbimi i sigurise fizike te objekteve te Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd*”, me fond limit 8 737 942 lekë pa tvsh, e parashikuar për t’u zhvilluar në datën 10.01.2018 autoriteti kontraktor, Sh.a Ujesjelles-Kanalizime Librazhd.

II.2. Në datën 14.12.2017 operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë ngrihen pretendime lidhur me hartimin e dokumentave të tenderit të mësipërm. Konkretisht pretendohet si vijon:

[...]

Më datën 12.12.2017, ndërmjet SPE-së shoqëria jonë u njoh me DST-të. Nga verifikimi i kriterëve të kualifikimit vumë re se ato nuk janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në kriteret e veçanta autoriteti ka kërkuar:

1. Subjekti SHPSF duhet të paraqesë Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për çdo vendndodhje ku ushtron biznes sipas njesive administrative në Shqipëri për vitin 2016, 2017 shoqëruar me NIPT-et sekondare perkatëse.

Kriteri i mësipërm nuk është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe frymën e legjislacionit të prokurimeve publike. Për autoritetin kontraktor duhet të jetë e rëndësishme paraqitja e dokumentit Nipt Sekondar për vendet ku operatorët janë të regjistruar në QKB. Për të ushtruar veprimtarinë e tyre, por në asnjë rast nuk duhet të kërkojmë nga ana e oe-ve të paraqesin Nipt Sekondar apriori nëse referuar ekstraktit të QKB-së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit nuk reluton që këta operatorë të kenë të regjistruar vend të uhtrimit të aktivitetit të tyre.

Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa më sipër duke kërkuar Nipt sekondar për të gjitha vendet ku operatorët ekonomikë ushtrjnë aktivitet referuar ekstraktit të QKB-së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në një rast të njëjtë për kriterin e sipërreferuar organi më i lartë në fushën e prokurimeve është shprehur referojmë vendimin e KPP-së [...]

Përsa më sipër kërkojmë heqjen nga kriteri të pjesës që ka të bëjë me paraqitjen e Nipt Sekondar.

2. Në kriteriin e vecantë autoriteti ka kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" me zone mbulimi qytetin ku do kryhet shërbimi. Operatorët ekonomik te vertetojnë me ane te xhirimit bankar dhe vertetim AKEP per shlyerjen e detyrimeve per dhjete mujorin e pare te vitit 2017.

Autoriteti duhet të kërkojë autorizim AKEP me zonë mbulimi vendodhjen e objektit pa përmendur qytet, pasi në rastin konkret përjashtohet shoqëria jonë e cila edhe pse e mbulon me AKEP vendodhjen e objektit, sërisht licenca mban emërtimin Qarkun Elbasan dhe jo qytetin ku kryhet shërbimi që përkon e Librazhdin. Referojmë nenin 46 pika 1 të LPP-së, nenin 66 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 i ndryshuar, (nenin 62;63;64;65;66;67;68;69;70 dhe 71 të këtij ligji)[..].

Referuar vendodhjes së objektit të prokurimit, kërkojmë që kriteri për paraqitjen e Autorizimit të lëshuar nga AKEP mjafton të jetë lëshuar nga autoriteti kompetent edhe për Qarkun Elbasan pjesë e së cilës është edhe qyteti ku do të kryhet shërbimi Librazhdi. Shoqëria jonë gjykon se për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që autorizimi të mbuloj me radio komunikim dhe radio alarm vendin e kryerjes së shërbimit. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërcituar duke përfshirë në të mundësinë e paraqitjes së autorizimit individual edhe për Qarkun Elbasan në mënyrë që të gjithë oe-të të mos kufizohen nga pjesmarrja në procedurën e prokurimit. Në një rast të tillë është shprehur dhe KPP. Referojmë vendimin e KPP-së[...].

3. Në kriteret e veçanta të kualifikimit autoriteti ka kërkuar:

Vertetim shoqëruar me listen emerore nga Drejtoria e Policise se Qarkut Elbasan te leshuar brenda vitit 2017, ku jepet informacion mbi gjendjen e shoqerise: Operatori ekonomik duhet te kete 17 punonjes te Certifikuar per ushtrim profesioni si dhe te paraqese certifikatat perkatëse , te kete 4 operatore, 1 grup te gatshem, 1 pergjegjes shërbimi, minimalisht 2 automjete, te mos kete marre mase administrative, ngjarje per vitin 2016-2017, te kete shlyer detyrimet per vitin 2015-2016, si dhe te kete pajisje speciale te shoqëruar dhe me dokumentacion blerje, jo me pak se 10 cope secilen: pranga lidhese, shkopinj gome, dedektore, radio, elektrik dore, spray.

Së pari në lidhje me kërkesën për ...17 punonjës shërbimi kërkojmë reduktimin e numrit të punonjësve në 12 të tillë pasi kërkesa është e ekzagjëruar dhe në kundërshtim me Tremat e Referencës në të cilat është specifikuar se shërbimi do të kryhet në një vendroje me shërbim 24 orë me 4.2 roje dhe në 3 vendroje me shërbim 16 orë me 2.8 roje. Referojmë specifikimet teknike të DST-ve[...].

Përsa më sipër kërkojmë ndryshimin e kriterit duke kërkuar 12 punonjës shërbimi.

Së dyti në lidhje me kërkesën ...4 operatorë kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi nuk është kërkesë e ligjshme. KPP është shprehur Referojmë vendimin e KPP-së[...].Sa më sipër kërkojmë heqjen nga kriteri i kërkesës për 4 operatorë.

Së treti në lidhje me kërkesën ... minimalisht 2 automjete, kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi është i dubluar. Kërkesa për automjete është kërkuar në një pikë tjetër të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe nuk ka pse të kërkohej edhe në vërtetim të lëshuar nga Policia. Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar:

Leje qarkullimi për jo më pak se 2 (dy) automjete dhe 1 motor të OE për perballimin e situatave emergjente që mund të lindin gjatë kryerjes së shërbimit. Në lidhje me këtë pikë të paraqiten kopje të lejes së qarkullimit të mjetit pronesi, pagesa e takses së kolaudit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit të ketë dëshminë e drejtimit të mjetit për këtë shërbim.

Sa më sipër kërkojmë heqjen nga kriteri vërtetim nga Policia, të kërkesës për dy automjete.

Së katërti, në lidhje me kërkesën përtë mos marrë masë administrative ngjarje për vitin 2016-2017 kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë pasi të kesh marrë një masë administrative apo të kesh patur një ngjarje nuk përbën kusht përjashtues nga pjesëmarrja në tender. Në asnjë pikë të legjislacionit për SHPSFT-të nuk është parashikuar se nëse oë ka një masë administrative apo ngjarje ai duhet të mos lejohet të marrë pjesë në prokurime. Ky kriter përjashton shoqërinë tonë përse kohë është kriter me efekt kualifikimi.

Për këtë arsye kërkojmë të hiqet kjo kërkesë pasi pengonte shoqërinë tonë të merrte pjesë dhe të kualifikohet në këtë procedurë.

Së pesti në lidhje me kërkesën përtë ketë pajisje speciale të shoqëruar dhe me dokumentacion blerjeje, jo më pak se 10 copë për secilën prangë lidhëse, shkopinj gome, dedektorë, radio, elektrik dore, spray, kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë nga vërtetimi i Policisë pasi këto janë pajisje që mund të blihen në kohë rekord dhe vërtetimi i tyre mund të bëhet fare mirë me faturën e blerjes dhe pagesat përkatëse. Për këtë arsye nuk ka pse të kërkohej që të vërtetohet disponimi i tyre edhe me vërtetim të policisë pasi është një kërkesë e dubluar.

Për këtë arsye, kërkojmë të hiqet nga vërtetimi i Policisë kjo kërkesë dhe të lihet vetëm me fatura tatimore dhe pagesat përkatëse.

4. Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar:

Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar – Tetor 2017, e shoqëruar me listëpagesat (formularët E-sig 025 a) ku të rezultojnë të siguruar punonjësit e certifikuar.

Kërkesa e mësipërme që "Punonjësit e certifikuar" duhet të rezultojnë të siguruar në listëpagesat e Janar-Tetor 2017 është një kërkesë që nuk i shërben për të arritur qëllimin pra, realizimi me sukses të kontratës nga operatori përkatës fitues.

Kërkesa që personat e certifikuar të përputhen me listëpagesat për periudhën e kërkuar është joproporcionale me objektin e prokurimit pasi për AK-në e nevojshme është që operatorët ekonomikë

pjesmarrës në procedurat e prokurimit të zotërojnë kapacitet e nevojshme ligjore, ekonomike, dhe teknike për realizimin me sukses të kontratës. Për AK-në është e rëndësishme që operatorët ekonomikë pjesmarrës të zotërojnë aktualisht numrin e punonjësve të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. AK-ja nuk mund të pretendojë që shoqëria jonë të vazhdojë të ketë po të njëjtët punonjës që ka patur edhe para 10 muajsh. Ky është një kriter diskriminues dhe abuziv. Përsa më sipër kërkojmë modifikimin e kriterit si vijon:

Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar-Tetor 2017, e shoqëruar me listëpagesat (formularët E-sig025a) ku te numrin e punonjësve të siguruar për këtë periudhë. Në një rast të ngjashëm autoriteti më i lartë në fushën e prokurimeve KPP-ja referojmë vendimin e KPP-së[...].

5. Në kriteret e veçanta të kualifikimit autoriteti ka kërkuar:

Leje qarkullimi për jo më pak se 2 (dy) automjete dhe 1 motorr të OE për perballimin e situatave emergjente që mund të lindin gjatë kryerjes së shërbimit. Në lidhje me këtë pikë të paraqiten kopje të lejes së qarkullimit të mjetit pronesi , pagesa e takses së kolaudit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit të ketë dëshminë e drejtimit të mjetit për këtë shërbim.

Së pari, kërkesa e mësipërme për disponimin e jo më pak se2 (dy) automjete dhe 1 motorr është një kërkesë tërësisht e ekzagjëruar dhe në disproporcion me objektin e tenderit. Kërkesa e mësipërme duhet të reduktohet duke kërkuar disponimin e jo më pak se 1 automjeti pasi është mëse e mjaftueshme për realizimin e objektit të tenderit.

Përsa më sipër kërkojmë ndryshimin e kriterit si në vijim:

Leje qarkullimi për jo më pak se 1 (një) automjet të OE për perballimin e situatave emergjente që mund të lindin gjatë kryerjes së shërbimit. Në lidhje me këtë pikë të paraqiten kopje të lejes së qarkullimit të mjetit pronesi , pagesa e takses së kolaudit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit të ketë dëshminë e drejtimit të mjetit për këtë shërbim.

Së dyti, kërkesa përpërdoruesi i mjetit të ketë dëshimë e drejtimit të mjetit për këtë shërbim, është një kërkesë që nuk ka asnjë lidhje me qëllimin e autoritetit kontraktor për krijimin e një ekiporame të përgjithshme mbi kapacitetin teknik të shoqërive pjesmarrëse në tender. Leja e drejtimit nuk është kapacitet por një kualifikim personal i një ose disa punonjësve dhe kjo nuk duhet të shërbejë si kriter kualifikues. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme disponimi i kapaciteteve teknike në rastin konkret mjete të mjaftueshme për realizimin me sukses të kontratës dhe barrierat tilla nuk duhet të shërbejnë për të vështirësuar pjesëmarrjen e oë-ve. Përsa më sipër kërkojmë ndryshimin e kriterit si më poshtë:

Leje qarkullimi për jo më pak se 1 (një) automjet të OE për perballimin e situatave emergjente që mund të lindin gjatë kryerjes së shërbimit. Në lidhje me këtë pikë të paraqiten kopje të lejes së qarkullimit të mjetit pronesi , pagesa e takses së kolaudit dhe siguracioni.

6. Në kriterin e veçantë të kualifikimit autoriteti ka kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatë ISO 9001:2008 dhe ISO 9001:2015 , si dhe certifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Pune BS OHSAS 18001-2007 ku të përfshihet edhe objekti i prokurimit.

Në një rast të ngjashëm KPP-ja referojmë vendimin e KPP-së[...]

Sa më sipër kërkojmë heqjen e kriterit për certifikatë ISO.

7. Në kriteret e veçanta të kualifikimit autoriteti ka kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikate për sigurinë e informacionit të klasifikuar në fushën industriale nga DSIK (Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar) për minimumi 4 persona të shoqërisë.

Referojmë Ligjin nr. 8457 datë 11.02.1999 konkretisht nenin 6 [...]

Ujësjiellës Librazhd nuk ka asnjë lidhje me sigurinë kombëtare për rrjedhojë kërkesa dihet të hiqet si e pa mbështetur në ligj.

Akoma më tej edhe sikur të pranojë këtë kërkesë në një moment autoriteti kontraktor duhet parashikonte procedurën për tu pajisur me këtë certifikatë pasi në si shoqëri as që kemi hasur ndonjë kërkesë të tillë më parë.

Akoma më tej në rastet kur kërkohet certifikatë e tillë procedura e prokurimit është “Sekrete” dhe nuk bëhet publike pasi ka të bëjë me të dhëna që përbëjnë “Sekret” apo informacion kofidencial, për rrjedhojë del e nevojshme edhe pajisja me këtë certifikatë. Referojmë shkresën e Drejtorisë së Informacionit të Klasifikuar[...]

II.3. Në datën 18.12.2017 nëpërmjet shkresës nr. 5/10 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e pranuar pjesërisht ankesën. (Duke pranuar kërkesën për heqjen e motorrit si mjet).

II.4. Në datën 19.12.2017 operatori ekonomik ankimes “Eurogjici Seciurity” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtuar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.5. Në datën 15.12.2017 operatori ekonomik “Dea Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë ngrihen pretendime lidhur me hartimin e dokumentave të tenderit të mësipërm. Konkretisht pretendohet si vijon:

[...]

Së pari në DST “Specifikimet Teknike” AK-ja shprehet se “Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Librazhd e ka si qëllim të prokurojë Shërbimin privat të sigurisë fizike në objektet e këtij institucioni me 1 vendroje me 4.2 punonjës me shërbim 24 ore dhe 3 vendroje me 2.8 punonjës me shërbim 16 orë.

Ky numër rojesh është i pamjaftueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore pasi referojmë udhëzimin nr. 308 datë 22.05.2017 për SHPSF-të KREU III gërma a), pika b përcakton se: Numrin e vendrojeve dhe numrin e punonjësve të shërbimit duke llogasitur për 40 orë punë në javë ose koeficienti 1.66 për një punonjës x çenti 1.66 për një punonjës shërbimi . Pra sipas përcaktimit ligjor :

Për vendrojen me tre turne (24 orë) numri i rojeve duhet të jetë: $1.66 \times 3 \text{ turne} = 4.98 \text{ roje}$

Për vendrojen me dy turne (16 orë) numri i rojeve duhet të jetë: $1.66 \times 2 \text{ turne} = 3.32 \text{ roje}$.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe KPP-ja në vendimin nr. 618/2017 datë 23.08.2017 Referojmë vendimin[...].

Pra në përputhje me udhëzimin nr. 308 dhe në bazë të kodit të punës autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë numrin e rojeve sipas përcaktimeve ligjore 4.98 roje për vendroje me (tre turne) dhe 3.32 për vendroje me (dy turne). Përfundimisht nga argumentimi i bërë sa më sipër kërkojmë nga ana juaj modifikimin e kriterëve të kualifikimit të përcaktuara në DST, të cilat kufizojnë pjesmarrjen në këtë procedurë prokurimi, dhe bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore që rregullojnë shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike.

II.6. Në datën 18.12.2017 nëpërmjet shkresës nr. 5/15 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke mos e pranuar ankesën.

II.7. Në datën 26.12.2017 operatori ekonomik ankimues “Dea Security” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtuar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.8. Autoriteti Kontraktor në sistemin e prokurimeve publike ka ngarkuar Shtojcë me përmbajtjen si më poshtë vijon:

Te sqaroje per DST operoret ekonomike si me poshte:

1. *Ne lidhje me kriterin “Subjekti SHPSF duhet të paraqesë Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për çdo vendndodhje ku ushtron biznes sipas njesive administrative ne Shqiperi per vitin 2016, 2017 shoqeruar me NIPT-et sekondare perkatese”*

sqarojme se:

Ne kriterin e dhene sa më sipër AK ka kërkuar Nipt për të gjitha vendet ku operatorët ekonomikë ushtrojnë aktivitet te regjistruar sipas QKB .

2. *Ne lidhje me kriterin “Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zone mbulimi qytetin ku do kryhet sherbimi. Operoret ekonomik te vertetojne me ane te xhirimit bankar dhe vertetim AKEP per shlyerjen e detyrimeve per dhjete mujorin e pare te vitit 2017”*

Sqarojme se:

Përsa më sipër, kërkesa për autorizimin individual, lëshuar nga AKEP-i me zone mbulimi qytetin ku do kryhet sherbimi, është një kërkesë e hartuar në përputhje me objektin e prokurimit, dhe ky kriter plotesohet nga OE qe kane AKEP me zone mbulimi qarkun qe perfshin qytetin ku do te kryhet sherbimi ne momentin.e neneshkrimit te kontrates.

2.Te modifikojë dokumentat standarte te tenderit me object prokurimi planifikuar per tu zhvilluar me daten 04.01.2018 ora 11.00 si me poshte:

ISHTE

Kerkesat e veçanta per kualifikim

Kapaciteti teknik:

“Leje qarkullimi per jo me pak se 2 (dy) automjete dhe 1 motorr te OE per perballimin e situatave emergjente qe mund te lindin gjate kryerjes se sherbimit. Ne lidhje me kete pike te paraqiten kopje te lejes se qarkullimit te mjetit pronesi , pagesa e taksës se kolaudimit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit te ketë dëshmine e drejtimit të mjetit për këtë shërbim

BEHET

Kerkesat e veçanta per kualifikim

Kapaciteti teknik:

“Leje qarkullimi per jo me pak se 2 (dy) automjete te OE per perballimin e situatave emergjente qe mund te lindin gjate kryerjes se sherbimit. Ne lidhje me kete pike te paraqiten kopje te lejes se qarkullimit te mjetit pronesi , pagesa e takses se kolaudit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit te ketë dëshmine e drejtimit të mjetit për këtë shërbim.

3.Te modifikoje daten e zhvillimit te tenderit si me poshte:

DATA ISHTE:

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 04/01/2018 (dd/mm/vvvv) Ora: 11:00

Vendi www.app.gov.al

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 04/01/2018 (dd/mm/vvvv) Ora: 11:00

Vendi: www..app.gov.al

DATA BEHET

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:


Data: 10/01/2018 (dd/mm/vvvv) Ora: 11:00

Vendi www..app.gov.al

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 10/01/2018 (dd/mm/vvvv) Ora: 11:00

Vendi: www..app.gov.al



Operatoret duhet te pergatitin dhe paraqesin oferte referuar ketyre modifikimeve.

*Shenim:**Afate e vlefshmerise se dokumentave qe do te paraqesin ofertuesit , do ti referohen dates se hapjes se ofertave , pra 10.01.2018.*

ps. Ju bejme me dije se KVO do te beje vleresimin e ofertave mbi bazen e kriterëve per kualifikim te modifikuara dhe afatet do ti llogarise referuar dates hapjes se ofertave 10.01.2018.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr.207/1prot., datë 28.12.2017 protokolluar me tonën me nr 1848/2datë 29.12.2017 me objekt “Dërgohet informacion mbi vendimin tuaj nr. 1848/1 datë 21.12.2017”, si dhe shkresës nr. 220/1prot., datë 03.01.2018 protokolluar me tonën 1885/2 datë 05.01.2018 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Eurogjici Secuity” sh.p.k se “Subjekti SHPSF duhet të paraqesë Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për çdo vendndodhje ku ushtron biznes sipas njesive administrative ne Shqiperi per vitin 2016, 2017 shoqeruar me NIPT-et sekondare perkatese.

Kriteri i mësipërm nuk është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe frymën e legjislacionit të prokurimeve publike. Për autoritetin kontraktor duhet të jetë e rëndësishme paraqitja e dokumentit Nipt Sekondar për vendet ku operatorët janë të regjistruar në QKB. Për të ushtruar veprimtarinë e tyre, por në asnjë rast nuk duhet të kërkojmë nga ana e oe-ve të paraqesin Nipt Sekondar apriori nëse referuar ekstraktit të QKB-së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit nuk rezulton që këta operatorë të kenë të regjistruar vend të ushtrimit të aktivitetit të tyre.

Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa më sipër duke kërkuar Nipt sekondar për të gjitha vendet ku operatorët ekonomikë ushtrojnë aktivitet referuar ekstraktit të QKB-së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në një rast të njëjtë për kriterin e sipër referuar organi më i lartë në fushën e prokurimeve është shprehur referojmë vendimin e KPP-së [...]

Përsa më sipër kërkojmë heqjen nga kriteri të pjesës që ka të bëjë me paraqitjen e Nipt Sekondar.”

Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti ligjor” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Subjekti SHPSF duhet të paraqesë Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për çdo vendndodhje ku ushtron biznes sipas njesive administrative ne Shqiperi per vitin 2016, 2017 shoqeruar me NIPT-et sekondare perkatese.

III.1.2. Autoriteti Kontraktor në sistemin e prokurimeve publike ka ngarkuar Shtojcë me përmbajtjen si më poshtë vijon:

[...]

Te sqaroje per DST operatorete ekonomike si me poshte:

Ne lidhje me kriterin “Subjekti SHPSF duhet të paraqesë Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për çdo vendndodhje ku ushtron biznes sipas njesive administrative ne Shqiperi per vitin 2016, 2017 shoqeruar me NIPT-et sekondare perkatese”

sqarojme se:

Ne kriterin e dhene sa më sipër AK ka kërkuar Nipt për të gjitha vendet ku operatorët ekonomikë ushtrojnë aktivitet te regjistruar sipas QKB.

III.1.3. Referuar Shtojcës të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike autoriteti kontraktor ka bërë sqarimin përkates, në të cilën është shprehur se: “[..]Nipt për të gjitha vendet ku operatorët ekonomikë ushtrojnë aktivitet të regjistruar sipas QKB-së”. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk ka vend për konfuzion ndërmjet operatorëve ekonomikë lidhur me përmbushjen e kriterit sa më sipër.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk do të merret në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Eurogjici Secuity” sh.p.k se “Në kriterin e vecantë autoriteti ka kërkuar: Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zone mbulimi qytetin ku do kryhet sherbimi. Operatoret ekonomik të vërtetojnë me ane të xhirimit bankar dhe vertetim AKEP për shlyerjen e detyrimeve për dhjetë mujorin e parë të vitit 2017.

Autoriteti duhet të kërkojë autorizim AKEP me zonë mbulimi vendodhjen e objektit pa përmendur qytet, pasi në rastin konkret përjashtohet shoqëria jonë e cila edhe pse e mbulon me AKEP vendodhjen e objektit, sërish licenca mban emërtimin Qarkun Elbasan dhe jo qytetin ku kryhet shërbimi që përkon me Librazhdin. Referojmë nenin 46 pika 1 të LPP-së, nenin 66 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 i ndryshuar, (nenin 62;63;64;65;66;67;68;69;70 dhe 71 të këtij ligji)[..].

Referuar vendodhjes së objektit të prokurimit, kërkojmë që kriteri për paraqitjen e Autorizimit të lëshuar nga AKEP mjafton të jetë lëshuar nga autoriteti kompetent edhe për Qarkun Elbasan pjesë e së cilës është edhe qyteti ku do të kryhet shërbimi Librazhdi. Shoqëria jonë gjykon se për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që autorizimi të mbulojë me radio komunikim dhe radio alarm vendin e kryerjes së shërbimit. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërcituar duke përfshirë në të mundësinë e paraqitjes së autorizimit individual edhe për Qarkun Elbasan në mënyrë që të gjithë oe-të të mos kufizohen nga pjesmarrja në procedurën e prokurimit. Në një rast të tillë është shprehur dhe KPP. Referojmë vendimin e KPP-së[...]. Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti teknik” pika 5 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zone mbulimi qytetin ku do kryhet sherbimi. Operatoret ekonomik të vërtetojnë me ane të xhirimit bankar dhe vertetim AKEP për shlyerjen e detyrimeve për dhjetë mujorin e parë të vitit 2017.

III.2.2. Autoriteti Kontraktor në sistemin e prokurimeve publike ka ngarkuar Shtojcë me përmbajtjen si më poshtë vijon:

[...]

Ne lidhje me kriterin “Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zone mbulimi qytetin ku do kryhet sherbimi. Operatoret ekonomik të vërtetojnë me ane të xhirimit bankar dhe vertetim AKEP për shlyerjen e detyrimeve për dhjetë mujorin e parë të vitit 2017”

Sqarojme se:

Përsa më sipër, kërkesa për autorizimin individual, lëshuar nga AKEP-i me zone mbulimi qytetin ku do kryhet sherbimi, është një kërkesë e hartuar në përputhje me objektin e prokurimit, dhe ky kriter plotësohet nga OE që kanë AKEP me zone mbulimi qarkun që përfshin qytetin ku do të kryhet sherbimi në momentin e nënshkrimit të kontratës.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-se përcaktohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit."*

III.2.4. Në nenin 66, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: *"AKEP-i lëshon një autorizim individual për përdorimin e frekuencave, në përputhje me PKRF-në dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave , për caktimin dhe përdorimin e frekuencave sipas neneve 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70 dhe 71 të këtij ligji." Në këto autorizime, përcaktohet edhe zona e mbulimit (neni 70, pika 1, e Ligjit të lartpërmendur), ku përcaktohet se "Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave përmban: a) të dhëna për përfituesin; b)frekuencat e përfituara ; c) vendndodhjen dhe zonën e mbulimit; ç) afatin e vlefshmërisë së autorizimit; d) kushtet, që duhet të përmbushen për 6 shfrytëzimin e frekuencës së caktuar, sipas nenit 71 të këtij ligji".*

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Referuar vendndodhjes së objektit të prokurimit, përkatësisht qyteti Librazhd Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri për paraqitjen e Autorizimit të lëshuar nga AKEP mjafton të jetë lëshuar nga autoriteti kompetent edhe për Qarkun Elbasan, pjesë e se cilës është edhe qyteti i Librazhdit. KPP gjykon se për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që autorizimi të mbulojë me radio komunikim dhe radio alarm vendin e kryerjes së shërbimit. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërcituar duke përfshirë në të, mundësinë e paraqitjes së autorizimit individual edhe për Qarkun Elbasan në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të mos kufizohen nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit. Pra, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë në mënyrë alternative disponimin e licencës për radiokomunikim dhe radioalarm për qytetin ose për qarkun në mënyrë që asnjë operator ekonomik të mos penalizohet sa kohë është i aftë të mbulojë me radiokomunikim dhe radioalarm vendin e kryerjes së shërbimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Eurogjici Secuity" sh.p.k se "Në kriteret e veçanta të kualifikimit autoriteti ka kërkuar:Vertetim shoqeruar me listen emerore nga Drejtoria e Policise se Qarkut Elbasan te leshuar brenda vitit 2017, ku jepet informacion mbi

gjendjen e shoqërisë: Operatori ekonomik duhet të ketë 17 punonjës të Certifikuar për ushtrim profesional si dhe të paraqesë certifikatat përkatëse, të ketë 4 operatore, 1 grup të gatshëm, 1 përgjegjës shërbimi, minimalisht 2 automjete, të mos ketë marrë masa administrative, ngjarje për vitin 2016-2017, të ketë shlyer detyrimet për vitin 2015-2016, si dhe të ketë pajisje speciale të shoqëruar dhe me dokumentacion blerje, jo më pak se 10 copë secilën: pranga lidhëse, shkopinj gome, dedektore, radio, elektrik dore, spray.

Së pari në lidhje me kërkesën për ...17 punonjës shërbimi kërkojmë reduktimin e numrit të punonjësve në 12 të tillë pasi kërkesa është e ekzagjëruar dhe në kundërshtim me Tërmatet e Referencës në të cilat është specifikuar se shërbimi do të kryhet në një vendroje me shërbim 24 orë me 4.2 roje dhe në 3 vendroje me shërbim 16 orë me 2.8 roje. Referojmë specifikimet teknike të DST-ve[...].

Përsa më sipër kërkojmë ndryshimin e kriterit duke kërkuar 12 punonjës shërbimi.

Së dyti në lidhje me kërkesën ...4 operatorë kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi nuk është kërkesë e ligjshme. KPP është shprehur Referojmë vendimin e KPP-së[...].Sa më sipër kërkojmë heqjen nga kriteri i kërkesës për 4 operatorë.

Së treti në lidhje me kërkesën ... minimalisht 2 automjete, kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi është i dubluar. Kërkesa për automjete është kërkuar në një pikë tjetër të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe nuk ka pse të kërkohej edhe në vërtetim të lëshuar nga Policia. Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar:

Leje qarkullimi për jo më pak se 2 (dy) automjete dhe 1 motor të OE për përballimin e situatave emergjente që mund të lindin gjatë kryerjes së shërbimit. Në lidhje me këtë pikë të paraqiten kopje të lejes së qarkullimit të mjetit pronesi, pagesa e takses së kolaudimit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit të ketë dëshminë e drejtimit të mjetit për këtë shërbim.

Sa më sipër kërkojmë heqjen nga kriteri vërtetim nga Policia, të kërkesës për dy automjete.

Së katërti, në lidhje me kërkesën përtë mos marrë masa administrative ngjarje për vitin 2016-2017 kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë pasi të kesh marrë një masë administrative apo të kesh patur një ngjarje nuk përbën kusht përjashtues nga pjesëmarrja në tender. Në asnjë pikë të legjislacionit për SHPSFT-të nuk është parashikuar se nëse oë ka një masë administrative apo ngjarje ai duhet të mos lejohet të marrë pjesë në prokurime. Ky kriter përjashton shoqërinë tonë përsa kohë është kriter me efekt kualifikimi.

Për këtë arsye kërkojmë të hiqet kjo kërkesë pasi pengonte shoqërinë tonë të merrte pjesë dhe të kualifikohet në këtë procedurë.

Së pesti në lidhje me kërkesën përtë ketë pajisje speciale të shoqëruar dhe me dokumentacion blerjeje, jo më pak se 10 copë për secilën pranga lidhëse, shkopinj gome, dedektorë, radio, elektrik dore, spray, kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë nga vërtetimi i Policisë pasi këto janë pajisje që mund të blihen në kohë rekord dhe vërtetimi i tyre mund të bëhet fare mirë me faturën e blerjes dhe pagesat përkatëse. Për këtë arsye nuk ka pse të kërkohej që të vërtetohet disponimi i tyre edhe me vërtetim të policisë pasi është një kërkesë e dubluar.

Për këtë arsye, kërkojmë të hiqet nga vërtetimi i Policisë kjo kërkesë dhe të lihet vetëm me fatura tatimore dhe pagesat përkatëse” Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Vertetim shoqeruar me listen emerore nga Drejtoria e Policise se Qarkut Elbasan te leshuar brenda vitit 2017, ku jepet informacion mbi gjendjen e shoqerise: Operatori ekonomik duhet te kete 17 punonjes te Certifikuar per ushtrim profesioni si dhe te paraqese certifikatat perkatese , te kete 4 operatore, 1 grup te gatshem, 1 pergjegjes sherbimi, minimalisht 2 automjete, te mos kete marre mase administrative, ngjarje per vitin 2016-2017, te kete shlyer detyrimet per vitin 2015-2016, si dhe te kete pajisje speciale te shoqeruar dhe me dokumentacion blerje, jo me pak se 10 cope secilen: pranga lidhese, shkopinj gome, dedektore, radio, elektrik dore, spray.

III.3.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Në përmbushje të shërbimeve të kërkuara, operatorët ekonomikë të përzgjedhur do të nënshkruajnë nje marrëveshje kuadër me Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd, sipas të cilës Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd. do të blejë Sherbimin e sigurisë fizike te objekteve te Sh.a Ujesjelles Kanalizime vetëm nga ato Operatorë Ekonomikë të cilët do të ofrojnë kete shërbimi, në përputhje me nevojat dhe specifikimet teknike të percaktuar nga Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Objektet e Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd e Prrenjas , qe kerkohen te ruhen nga (SH.P.S.F) eshte objekti depo uji Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd e Prrenjas ka si qellim te prokuroje Sherbimin privat te sigurisë fizike ne objektet e ketij institucioni me 1 vendroje ne objektin Qarrishte (mali Kallkan) me 4.2 punonjes me sherbim 24 ore (turni I-II-III-te dhe 3 vendroje ne Librazhd,Prrenjas ,Qafthane me 2.8 punonjes me sherbim 16 ore (turni II-III-te).

III.3.3. Në shtojcën 12 “Termat e Referencës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objektet e Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd e Prrenjas , qe kerkohen te ruhen nga (SH.P.S.F) eshte objekti depo uji Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd e Prrenjas ka si qellim te prokuroje Sherbimin privat te sigurisë fizike ne objektet e ketij institucioni me 1 vendroje ne objektin Qarrishte (mali Kallkan) me 4.2 punonjes me sherbim 24 ore (turni I-II-III-te dhe 3 vendroje ne Librazhd,Prrenjas ,Qafthane me 2.8 punonjes me sherbim 16 ore (turni II-III-te).

III.3.4. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-se përcakohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit."

Në nenin 28, pika 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar përcaktohet shprehimisht: Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[..]

III.3.5. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat nuk duhet të tejkalojnë objektin e prokurimit. KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërcituar, duke ulur numrin prej 17 punonjësish të certifikuar, në përputhje me volumnin dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.5.1. Në lidhje me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kriterit me argumentat se "Së dyti në lidhje me kërkesën ...4 operatorë kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi nuk është kërkesë e ligjshme. KPP është shprehur Referojmë vendimin e KPP-së[...].Sa më sipër kërkojmë heqjen nga kriteri i kërkesës për 4 operatorë.", Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të vërtetojë se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike (në rastin konkret kapaciteti për operator), mjaftueshëm sa të jetë në gjendje të realizojë kontratën objekt i këtij prokurimi. Përcaktimi i numrit të operatorëve në mënyrë të ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e kontratës, referuar kjo dhe vendrojeve të caktuara, objektit që do të ruhet dhe shërbimit që do të kryhet, të përcaktura këto në dokumentat e tenderit, nuk i shërbejnë qëllimit për të cilin vendoset kriteri, por kufizojnë pjesëmarrjen dhe konkurrencën.

Për rrjedhojë kriteri i mësipërm i kërkuar nga autoriteti kontraktor duhet të modifikohet në lidhje me numrin e operatorëve në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.5.2. Në lidhje me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kriterit me argumentat se "Së treti në lidhje me kërkesën ... minimalisht 2 automjete, kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi është i dubluar. Kërkesa për automjete është kërkuar në një pikë tjetër të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe nuk ka pse të kërkohet edhe në vërtetim e lëshuar nga Policia.Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar:

Leje qarkullimi per jo me pak se 2 (dy) automjete dhe 1 motorr te OE per perballimin e situatave emergjente qe mund te lindin gjate kryerjes se sherbimit. Ne lidhje me kete pike te paraqiten kopje te lejes se qarkullimit te mjetit pronesi , pagesa e takses se kolaudimit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit te ketë dëshmine e drejtimit të mjetit për këtë shërbim.

Sa më sipër kërkohet heqjen nga kriteri vërtetim nga Policia , të kërkesës për dy automjete.”,Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.5.3. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti teknik” pika 8 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Leje qarkullimi per jo me pak se 2 (dy) automjete dhe 1 motorr te OE per perballimin e situatave emergjente qe mund te lindin gjate kryerjes se sherbimit. Ne lidhje me kete pike te paraqiten kopje te lejes se qarkullimit te mjetit pronesi , pagesa e takses se kolaudimit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit te ketë dëshmine e drejtimit të mjetit për këtë shërbim.

III.3.5.4. Autoriteti Kontraktor në sistemin e prokurimeve publike ka ngarkuar Shtojcë me përmbajtjen si më poshtë vijon:

ISHTE

Kerkesat e veçanta per kualifikim

Kapaciteti teknik:

“Leje qarkullimi per jo me pak se 2 (dy) automjete dhe 1 motorr te OE per perballimin e situatave emergjente qe mund te lindin gjate kryerjes se sherbimit. Ne lidhje me kete pike te paraqiten kopje te lejes se qarkullimit te mjetit pronesi , pagesa e takses se kolaudimit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit te ketë dëshmine e drejtimit të mjetit për këtë shërbim

BEHET

Kerkesat e veçanta per kualifikim

Kapaciteti teknik:

“Leje qarkullimi per jo me pak se 2 (dy) automjete te OE per perballimin e situatave emergjente qe mund te lindin gjate kryerjes se sherbimit. Ne lidhje me kete pike te paraqiten kopje te lejes se qarkullimit te mjetit pronesi , pagesa e takses se kolaudimit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit te ketë dëshmine e drejtimit të mjetit për këtë shërbim.

3.Te modifikoje daten e zhvillimit te tenderit si me poshte:

III.3.5.5. Komisioni gjykon se kriteri i mësipërm në drejtim të provueshmërinë së disponimit të 2 automjeteve, nuk vërtetohet nëpërmjet dokumentave të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Elbasan, por sipas dokumentave që vërtetojnë pronësinë apo dokumentave të cilat nevojiten për qarkullimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi. Për më tepër që një kërkesë të tillë autoriteti kontraktor e ka përcaktuar në shtojcën 7 të “Kritereve të veçanta të kualifikimit “Kapaciteti Teknik” pika 8 të

dokumentave të tenderit ku kërkohet shprehimisht: *Leje qarkullimi për jo më pak se 2 (dy) automjete dhe 1 motorr të OE për përballimin e situatave emergjente që mund të lindin gjatë kryerjes së shërbimit. Ne lidhje me kete pike te paraqiten kopje te lejes se qarkullimit te mjetit pronesi , pagesa e takses se kolaudit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit te ketë dëshmine e drejtimit të mjetit për këtë shërbim.*

KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentat e tenderit duke e hequr kërkesën që në vërtetimin e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan të vërtetohet se disponojnë dy automjete në përdorim pasi është tërësisht e panevojshme, e përsëritur dhe jo funksion të realizimit me sukses të objektit të prokurimit.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.5.6. Në lidhje me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kriterit me argumentat se *“Së katërti, në lidhje me kërkesën përtë mos marrë masë administrative ngjarje për vitin 2016-2017 kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë pasi të kesh marrë një masë administrative apo të kesh patur një ngjarje nuk përbën kusht përjashtues nga pjesmarrja në tender. Në asnjë pikë të legjislacionit për SHPSFT-të nuk është parashikuar se nëse oe ka një masë administrative apo ngjarje ai duhet të mos lejohet të marrë pjesë në prokurime. Ky kriter përjashton shoqërinë tonë përse kohë është kriter me efekt kualifikimi.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.5.7. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë të cilët duhet të dëshmojnë seriozitet, besueshmëri gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre. Kriteri i vendosur për mospasjen *masë administrative, ngjarje për vitin 2016-2017*, nga ana e operatorëve ekonomikë pjesmarrës të mundshëm, gjatë veprimtarisë së tyre nuk përbën në vetvete një kriter diskriminues dhe nuk i tejkalon përmasat e kontratës së prokuruar. Komisioni gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron të gjitha kapacitetet për realizimin e kontratës me sukses në afat dhe në cilësi sipas përcaktimeve të dokumentave standarte të tenderit.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3.5.8. Në lidhje me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kriterit me argumentat se *“Së pesti në lidhje me kërkesën përtë ketë pajisje speciale të shoqëruar dhe me dokumentacion blerjeje, jo më pak se 10 copë për secilën pranga lidhëse, shkopinj gome, dedektorë, radio, elektrik dore, spray, kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë nga vërtetimi i Policisë pasi këto janë pajisje që mund të blihen në kohë rekord dhe vërtetimi i tyre mund të bëhet fare mirë me faturën e blerjes dhe pagesat përkatëse. Për këtë arsye nuk ka pse të kërkohet që të vërtetohet disponimi i tyre edhe me vërtetim të policisë pasi është një kërkesë e dubluar.*

Për këtë arsye, kërkojmë të hiqet nga vërtetimi i Policisë kjo kërkesë dhe të lihet vetëm me fatura tatimore dhe pagesat përkatëse”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

Lidhur me kërkesën e ankimuesit “heqjen e kriterit që i referohet informacionit që duhet të japë vërtetimi i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan mbi mjetet që disponon operatori ekonomik për dedektor, 10 copë për secilën pranga lidhëse, shkopinj gome, dedektorë, radio, elektrik dore, spray të OE-së; pasi është një kërkesë e dubluar (pasi këto janë pajisje që mund të blihen në kohë rekord dhe vërtetimi i tyre mund të bëhet fare mirë me faturën e blerjes dhe pagesat përkatëse.)”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se duke qenë se pajisjet në fjalë janë pajisje ndihmëse në funksion të kryerjes me sukses të shërbimit të përcaktuar në kontratën objekt prokurimi, është e mjaftueshme që operatori ekonomik të tregojë se disponon pajisjet/mjetet në fjalë në mënyrë opsionale ose nëpërmjet Vërtetimit lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Elbasan ose nëpërmjet paraqitjes së faturën tatimore për blerjen e tyre. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në fjalë.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Eurogjici Security” sh.p.k se “Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar:

Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar – Tetor 2017, e shoqeruar me listepagesat (formularet E-sig 025 a) ku te rezultojn te siguruar punonjesit e certifikuar.

Kërkesa e mësipërme që ”Punonjësit e certifikuar” duhet të rezultojnë të siguruar në listëpagesat e Janar-Tetor 2017 është një kërkesë që nuk i shërben për të arritur qëllimin pra, realizimi me sukses të kontratës nga operatori përkatës fitues.

Kërkesa që personat e certifikuar të përputhen me listëpagesat për periudhën e kërkuar është joproporcionale me objektin e prokurimit pasi për AK-në e nevojshme është që operatorët ekonomikë pjesmarrës në procedurat e prokurimit të zotërojnë kapacitet e nevojshme ligjore, ekonomike, dhe teknike për realizimin me sukses të kontratës. Për AK-në është e rëndësishme që operatorët ekonomikë pjesmarrës të zotërojnë aktualisht numrin e punonjësve të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. AK-ja nuk mund të pretendojë që shoqëria jonë të vazhdojë të ketë po të njëjtët punonjës që ka patur edhe para 10 muajsh. Ky është një kriter diskriminues dhe abuziv. Përsa më sipër kërkojmë modifikimin e kriterit si vijon:

Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar-Tetor 2017, e shoqëruar me listëpagesat (formularët E-sig025a) ku te numrin e punonjësve të siguruar për këtë periudhë. Në një rast të ngjashëm autoriteti më i lartë në fushën e prokurimeve KPP-ja referojmë vendimin e KPP-së[...].” Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti teknik” pika 7 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar – Tetor 2017, e shoqeruar me listepagesat (formularet E-sig 025 a) ku te rezultojn te siguruar punonjesit e certifikuar.

III.4.2. Komisioni lidhur me kriterin sa më sipër se në listpagesat e shoqërisë për periudhën *Janar – Tetor 2017*, në të cilat të përputhen personat e licensuar (çertifikuar) me list-pagesat, për periudhën e kërkuar është një kërkesë e ekzagjeruar dhe gati të pamundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi. Komisioni gjykon se operatorët ekonomikë për shkaqe nga më të ndryshmet, janë të detyruar që të bëjnë ndryshime në stafin e tyre cka cdo të thotë që kjo nuk është një e dhënë statike e pandryshueshme në kohë. Ndryshueshmëria e stafit teknik /operativ të operatorëve ekonomikë lidhet me praktikën e brendshme të tyre dhe nuk ndikon aspak në tregues të performancës që duhet ti shërbejnë autoritetit kontraktor si garanci në kriteret kualifikuese. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë që punonjësit e çertifikuar të nevojshëm për kryerjen e shërbimit të figurojnë në listpagesat e e sigurimeve shoqërore për periudhën *Janar – Tetor 2017*, pasi operatorët ekonomike në varësi të nevojave të tyre kanë të drejtë të shtojnë apo reduktojnë staf në periudha të caktuara kohore.

Kriteri sa më sipër nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës dhe është tërësisht i panevojshëm. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që në drejtim të plotësimit të kapacitetit teknik profesional operatorët ekonomikë me anë të dokumentacionit konkret të lëshuar nga organet kompetente provojnë se disponojnë numrin e kërkuar të punonjësve të shërbimit dhe gjithashtu punonjësit aktualë të jenë të siguruar por kursesi të kushtëzojë operatorët ekonomikë që punonjësit e certifikuar të figurojnë në listpagesa për të gjithë periudhën e specifikuar më sipër

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Eurogjiçi Security” sh.p.k se “Në kriteret e veçanta të kualifikimit autoriteti ka kërkuar: *Leje qarkullimi për jo me pak se 2 (dy) automjete dhe 1 motorr të OE për perballimin e situatave emergjente që mund të lindin gjatë kryerjes së shërbimit. Në lidhje me këtë pikë të paraqiten kopje të lejes së qarkullimit të mjetit pronesi , pagesa e takses së kolaudit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit të ketë dëshminë e drejtimit të mjetit për këtë shërbim.*

Së pari, kërkesa e mësipërme për disponimin e jo më pak se2 (dy) automjete dhe 1 motorr është një kërkesë tërësisht e ekzagjeruar dhe në disproporcion me objektin e tenderit. Kërkesa e mësipërme duhet të reduktohet duke kërkuar disponimin e jo më pak se 1 automjeti pasi është mëse e mjaftueshme për realizimin e objektit të tenderit.

Përsa më sipër kërkojmë ndryshimin e kriterit si në vijim:

Leje qarkullimi për jo me pak se 1 (një) automjet të OE për perballimin e situatave emergjente që mund të lindin gjatë kryerjes së shërbimit. Në lidhje me këtë pikë të paraqiten kopje të lejes së qarkullimit të mjetit pronesi , pagesa e takses së kolaudit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit të ketë dëshminë e drejtimit të mjetit për këtë shërbim.

Së dyti, kërkesa përpërdoruesi i mjetit të ketë dëshinë e drejtimit të mjetit për këtë shërbim, është një kërkesë që nuk ka asnjë lidhje me qëllimin e autoritetit kontraktor për krijimin e një panorame të përgjithshme mbi kapacitetin teknik të shoqërive pjesmarrëse në tender. Leja e drejtimit nuk është kapacitet por një kualifikim personal i një ose disa punonjësve dhe kjo nuk duhet të shërbejë si kriter kualifikues. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme disponimi i kapaciteteve teknike në rastin konkret mjete të mjaftueshme për realizimin me sukses të kontratës dhe barriera të tilla nuk duhet të

shërbejnë për të vështirësuar pjesmarrjen e oe-ve. Përsa më sipër kërkojmë ndryshimin e kriterit si më poshtë:

Leje qarkullimi per jo me pak se 1 (një) automjet te OE per perballimin e situatave emergjente qe mund te lindin gjate kryerjes se sherbimit. Ne lidhje me kete pike te paraqiten kopje te lejes se qarkullimit te mjetit pronesi , pagesa e takses se kolaudimit dhe siguracioni” Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti teknik” pika 8 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Leje qarkullimi per jo me pak se 2 (dy) automjete dhe 1 motorr te OE per perballimin e situatave emergjente qe mund te lindin gjate kryerjes se sherbimit. Ne lidhje me kete pike te paraqiten kopje te lejes se qarkullimit te mjetit pronesi , pagesa e takses se kolaudimit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit te ketë dëshmine e drejtimit të mjetit për këtë shërbim.

III.5.2. Autoriteti Kontraktor në sistemin e prokurimeve publike ka ngarkuar Shtojcë me përmbajtjen si më poshtë vijon:

ISHTE

Kerkesat e veçanta per kualifikim

Kapaciteti teknik:

“Leje qarkullimi per jo me pak se 2 (dy) automjete dhe 1 motorr te OE per perballimin e situatave emergjente qe mund te lindin gjate kryerjes se sherbimit. Ne lidhje me kete pike te paraqiten kopje te lejes se qarkullimit te mjetit pronesi , pagesa e takses se kolaudimit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit te ketë dëshmine e drejtimit të mjetit për këtë shërbim

BEHET

Kerkesat e veçanta per kualifikim

Kapaciteti teknik:

“Leje qarkullimi per jo me pak se 2 (dy) automjete te OE per perballimin e situatave emergjente qe mund te lindin gjate kryerjes se sherbimit. Ne lidhje me kete pike te paraqiten kopje te lejes se qarkullimit te mjetit pronesi , pagesa e takses se kolaudimit dhe siguracioni Përdoruesi i mjetit te ketë dëshmine e drejtimit të mjetit për këtë shërbim.

3.Te modifikoje daten e zhvillimit te tenderit si me poshte:

III.5.3. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Në përmbushje të shërbimeve të kërkuara, operatorët ekonomikë të përzgjedhur do të nënshkruajnë nje marrëveshje kuadër me Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd, sipas të cilës Sh.a Ujesjelles

Kanalizime Librazhd. do të blejë Sherbimin e sigurisë fizike të objekteve të Sh.a Ujesjelles Kanalizime vetëm nga ato Operatorë Ekonomikë të cilët do të ofrojnë këto shërbime, në përputhje me nevojat dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Objektet e Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd e Prrenjas , që kerkohen të ruhen nga (SH.P.S.F) është objekti depo uji Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd e Prrenjas ka si qëllim të prokurojë Sherbimin privat të sigurisë fizike në objektet e këtij institucioni me 1 vendroje në objektin Qarrishte (mali Kallkan) me 4.2 punonjes me shërbim 24 ore (turni I-II-III-te dhe 3 vendroje në Librazhd,Prrenjas ,Qafthane me 2.8 punonjes me shërbim 16 ore (turni II-III-te).

III.5.4. Në shtojcën 12 “Termat e Referencës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objektet e Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd e Prrenjas , që kerkohen të ruhen nga (SH.P.S.F) është objekti depo uji Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd e Prrenjas ka si qëllim të prokurojë Sherbimin privat të sigurisë fizike në objektet e këtij institucioni me 1 vendroje në objektin Qarrishte (mali Kallkan) me 4.2 punonjes me shërbim 24 ore (turni I-II-III-te dhe 3 vendroje në Librazhd,Prrenjas ,Qafthane me 2.8 punonjes me shërbim 16 ore (turni II-III-te).

III.5.5. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-se përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.5.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti për disponimin e dy automjeteve për realizimin e kontratës në fjalë është në proporcion me objektin dhe vëllimin e kontratës. Autoriteti kontraktor dhe përkatësisht njësia e hartimit të dokumentave të tenderit ka detyrimin ligjor që gjatë vendosjes së kriterëve të veçanta për kualifikim të argumentojë ato me qëllim që të jenë në përputhje me rregullat e prokurimit publik si dhe në proporcion me objektin dhe vëllimin e kontratës.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron

Në lidhje me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues se Përdoruesi i mjetit të ketë dëshminë e drejtimit të mjetit për këtë shërbim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ky dokument është lehtësisht i disponueshëm nga ana e operatorëve ekonomikë, e si i tillë mund të paraqitet në përmbushje të kriterit të mësipërm. Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteri nuk është diskriminues, dhe nuk ndikon në uljen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë. Është në të drejtën e Autoriteti Kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomikë, përmbushjen

e kriterëve të cilat ai i gjykon të nevojshme për realizimin e kontratës, përsa kohë ato janë të lidhura me aftësinë zbatuese të kontratës.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike dhe personelin e nevojshëm, në përputhje dhe në përpjestim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Për rrjedhojë kriteri i mësipërm i kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk duhet të modifikohet në lidhje me dëshminë e drejtimit të mjetit për këtë shërbim. (leje drejtimi).

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Eurogjici Secuity” sh.p.k se “Në kriterin e veçantë të kualifikimit autoriteti ka kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikate ISO 9001:2008 dhe ISO 9001:2015 , si dhe certifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë ne Pune BS OHSAS 18001-2007 ku të përfshihet edhe objekti i prokurimit.

Në një rast të ngjashëm KPP-ja referojmë vendimin e KPP-së[...] *”Sa më sipër kërkojmë heqjen e kriterit për certifikata ISO.”* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti teknik” pika 12 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikate ISO 9001:2008 dhe ISO 9001:2015 , si dhe certifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë ne Pune BS OHSAS 18001-2007 ku të përfshihet edhe objekti i prokurimit.

III.6.2. Në nenin 46, pika 2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.*”

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*”

Në nenin 30 të VKM nr. 914 dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se “*Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata*

të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. *Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit*”

III.6.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i mësipërm nuk është proporcional objektin e prokurimit. Për vetë specifikën që kanë shoqëritë private të sigurisë fizike, veprimtaria e tyre gjen një rregullim të posaçëm nga lex specialis Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” si edhe nga aktet nën ligjore në zbatim të tij. Për sa më sipër, Licencimi nga Q.K.L., si edhe Licencat e lëshuara nga DPQ-të i japin garanci të mjaftueshme autoritetit kontraktor në lidhje me certifikimin e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Eurogjici Security” sh.p.k se “Në kriteret e veçanta të kualifikimit autoriteti ka kërkuar: Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikate për sigurinë e informacionit të klasifikuar në fushën industriale nga DSIK (Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar) për minimumi 4 persona të shoqërisë.

Referojmë Ligjin nr. 8457 datë 11.02.1999 konkretisht nenin 6 [...]

Ujësja Librazhd nuk ka asnjë lidhje me sigurinë kombëtare për rrjedhojë kërkesa dihet të hiqet si e pa mbështetur në ligj.

Akoma më tej edhe sikur të pranojë këtë kërkesë në një moment autoriteti kontraktor duhej parashikonte procedurën për tu pajisur me këtë certifikatë pasi në si shoqëri as që kemi hasur ndonjë kërkesë të tillë më parë.

Akoma më tej në rastet kur kërkohet certifikatë e tillë procedura e prokurimit është “Sekrete” dhe nuk bëhet publike pasi ka të bëjë me të dhëna që përbëjnë “Sekret” apo informacion kofidencial, për rrjedhojë del e nevojshme edhe pajisja me këtë certifikatë. Referojmë shkresën e Drejtorisë së Informacionit të Klasifikuar[...]” Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti teknik” pika 13 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikate për sigurinë e informacionit të klasifikuar në fushën industriale nga DSIK (Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar) për minimumi 4 persona të shoqërisë.

Në nenin 6 pika 1 të ligjit nr. 8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

Informacioni do t’i nënshtrohet procesit të klasifikimit kur lidhet me:

a) *plane ushtarake, armatime ose operacione;*

b) *aftësi apo dobësi, kapacitete të sistemeve, instalimeve, projekteve dhe planeve që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare;*

c) veprimtari të shërbimeve informative, me forma dhe metoda të punës, me kriptologji në objektet e mjetet teknike, në vendet ku përpunohet dhe arkivat ku ruhet informacioni;

ç) informacione të qeverive të huaja, marrëdhënie ndërkombëtare ose me veprimtari ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe me burime konfidenciale;

d) çështje shkencore, teknologjike dhe ekonomike që kanë lidhje me sigurinë kombëtare

III.7.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.7.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i mësipërm nuk është proporcional objektin e prokurimit. Kërkesa e autoritetit kontraktor që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kenë *certifikate për sigurinë e informacionit të klasifikuar* është një kriter i ekzagjeruar dhe që nuk përputhet me natyrën e kontratës objekt prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Dea Security” sh.p.k se “Së pari në DST “Specifikimet Teknike” AK-ja shprehet se “Sh.a Ujesjellës Kanalizime Librazhd e ka si qëllim të prokurojë Shërbimin privat të sigurisë fizike në objektet e këtij institucioni me 1 vendroje me 4.2 punonjës me shërbim 24 ore dhe 3 vendroje me 2.8 punonjës me shërbim 16 orë.

Ky numër rojesh është i pamjaftueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore pasi referojmë udhëzimin nr. 308 datë 22.05.2017 për SHPSF-të KREU III(gërma a), pika b përcakton se: Numrin e vendrojeve dhe numrin e punonjësve të shërbimit duke llogasitur për 40 orë punë në javë ose koeficienti 1.66 për një punonjës koeficienti 1.66 për një punonjës shërbimi . Pra sipas përcaktimit ligjor :

Për vendrojen me tre turne (24 orë) numri i rojeve duhet të jetë: $1.66 \times 3 \text{ turne} = 4.98 \text{ roje}$

Për vendrojen me dy turne (16 orë) numri i rojeve duhet të jetë: $1.66 \times 2 \text{ turne} = 3.32 \text{ roje}$.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe KPP-ja në vendimin nr. 618/2017 datë 23.08.2017 Referojmë vendimin[...].

Pra në përputhje me udhëzimin nr. 308 dhe në bazë të kodit të punës autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë numrin e rojeve sipas përcaktimeve ligjore 4.98 roje për vendroje me (tre turne) dhe 3.32 për vendroje me (dy turne). Përfundimisht nga argumentimi i bërë sa më sipër kërkojmë nga ana juaj modifikimin e kriterëve të kualifikimit të përcaktuara në DST, të cilat kufizojnë pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi, dhe bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore që rregullojnë shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike.” Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.8.1. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Në përmbushje të shërbimeve të kërkuara, operatorët ekonomikë të përzgjedhur do të nënshkruajnë një marrëveshje kuadër me Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd, sipas të cilës Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd. do të blejë Sherbimin e sigurisë fizike të objekteve të Sh.a Ujesjelles Kanalizime vetëm nga ato Operatorë Ekonomikë të cilët do të ofrojnë këto shërbime, në përputhje me nevojat dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Objektet e Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd e Prrenjas , që kerkohen të ruhen nga (SH.P.S.F) është objekti depo uji Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd e Prrenjas ka si qëllim të prokurojë Sherbimin privat të sigurisë fizike në objektet e këtij institucioni me 1 vendroje në objektin Qarrishte (mali Kallkan) me 4.2 punonjes me sherbim 24 ore (turni I-II-III-te dhe 3 vendroje në Librazhd,Prrenjas ,Qafthane me 2.8 punonjes me sherbim 16 ore (turni II-III-te).

III.8.2. Në shtojcën 12 “Termat e Referencës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objektet e Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd e Prrenjas , që kerkohen të ruhen nga (SH.P.S.F) është objekti depo uji Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd e Prrenjas ka si qëllim të prokurojë Sherbimin privat të sigurisë fizike në objektet e këtij institucioni me 1 vendroje në objektin Qarrishte (mali Kallkan) me 4.2 punonjes me sherbim 24 ore (turni I-II-III-te dhe 3 vendroje në Librazhd,Prrenjas ,Qafthane me 2.8 punonjes me sherbim 16 ore (turni II-III-te).

III.8.3. VKM nr. 399, datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” ku shprehimisht përcaktohet: “[...] Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale, orare, të jetë 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) lekë.[...]”

III.8.4. Në Ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 18, gërma “g” është përcaktuar: “Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

III.8.5. Referuar “Kodit të Punës” e më konkretisht:

Neni 81 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Shtesa mbi pagë”

“Çdo orë pune e kryer nga ora 19.00 deri në 22.00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20% dhe çdo orë pune e kryer midis intervalit 22.00 dhe 6.00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 50%”,

Neni 82 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Koha javore e punës”

Me kohëzgjatje javore të punës kuptohet koha e punës e kryer nga e hëna në mëngjes ora 0 deri të dielën e ardhshme ora 2400. Në nenin 83 të “Kodit të Punës”, është parashikuar: « Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kontratën kolektive ose në kontratën individuale të punës”.

Neni 85 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Pushimi javor”

- 1) Pushimi javor është jo më pak se 36 orë, prej të cilave 24 orë pa ndërprerje.*
- 2) Pushimi javor përfshin ditën e diel.*
- 3) Pushimi javor nuk është i pagueshëm.*
- 4) Përjashtimet rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

Neni 86 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Ditët e festave zyrtare”

- 1) Si rregull ndalohet puna në ditët e festave zyrtare.*
- 2) Punëmarrësi gëzon të drejtën e pagës në ditët e festave zyrtare.*

Kur dita e festës zyrtare bie në ditët e pushimit javor, pushimi shtyhet ditën e hënë.

- 3) Përjashtimet për të punuar në ditët e festave zyrtare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose në kontratën kolektive.*

Në nenin 87, po këtui, “puna e kryer ditën e pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompesohet me një shtesë page jo më pak se 25% ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune, që merret një jave para ose pas kryerjes së saj.”;

Neni 92 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Pushimet vjetore/Kohëzgjatja”

- 1) Kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohen me kontratën kolektive ose me kontratën individuale të punës.*
- 2) Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim.*
- 3) Kur punëmarrësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës. Periudhat e paaftësisë së përkohshme në punë, konsiderohen si kohë pune.*

III.8.6. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit, është 16,7%, referuar VKM-së nr.77, dt. 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

III.8.7. Referuar bazës ligjore të mësipërme, specifikimeve teknike termave të referencës të hartuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit, ku rezulton që shërbimi do të kryhet 1 vëndroje me 4.2 punonjës me shërbim 24 ore me tre turne (turni I-II-III-të), dhe 3 vëndroje me 2.8 punonjës me shërbim 16 orë me dy turne (I-II-të), KPP gjykon se numri i rojeve për vëndoroje (koeficienti i zëvendësimit) përlllogariur nga autoriteti kontraktor është i pamjaftueshëm. Autoriteti

kontraktor duhet të rishikojë numrin e rojeve për vendroje në përputhje me specifikimet teknike dhe llojin e shërbimit të kërkuar, rrjedhimisht edhe përlllogaritja e vlerës së fondit limit të kontratës nuk është e mjaftueshme. Nisur nga sa më lart rrjedhimisht autoriteti kontraktor duhet të rishikojë edhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës, duke marrë në konsideratë përcaktimet ligjore të sipërcituara. Në këto kushte autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të hartojë kriteret e veçanta të kualifikimit si dhe të përlllogarisë fondin limit, duke marrë në konsideratë përcaktimet ligjore të sipërcituara.

Nga ana tjetër autoriteti kontraktor në rishpalljen e procedurës së prokurimit, si dhe në përcaktimin e numrit të rojeve për vendroje (koeficienti i zëvendësimit) duhet të mbajë në konsideratë Rekomandimin e APP-së dhe KPP-së të datës 20.12.2017, protokolluar nga APP-ja me nr. 15/66prot., datë 20.12.2017, dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me nr. 1858 prot., datë 20.12.2017 në pikën 1 të tij parashikohet shprehimisht se:” [...]Për shërbimin 24 orë pa ndërprerje (nga e hëna në të dielë), numri i rojeve për vendroje duhet të llogaritet me koeficientin e zëvendësimit 1.66 punojës për turn”.

Për rrjedhojë pretendimi i ankimesit qëndron

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri



Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-37288-12-11-2017 me objekt: “Shërbimi i sigurisë fizike të objekteve të Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd”, me fond limit 8 737 942 lekë pa tvsh, e parashikuar për t’u zhvilluar në datën 10.01.2018 autoriteti kontraktor, Sh.a Ujesjelles-Kanalizime Librazhd.
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dea Security” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-37288-12-11-2017 me objekt: “Shërbimi i sigurisë fizike të objekteve të Sh.a Ujesjelles Kanalizime Librazhd”, me fond limit 8 737 942 lekë pa tvsh, e parashikuar për t’u zhvilluar në datën 10.01.2018 autoriteti kontraktor, Sh.a Ujesjelles-Kanalizime Librazhd.
3. Anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit dhe me rishpalljen e saj, autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” sh.p.k dhe “Dea Security” shpk.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1848 Prot;Datë 19.12.2017; Nr. 1885 Prot;Datë 26.12.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

